



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**Psh. nr. 536/22**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A paragrafi 3.1 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 4.1 pika (a) i "Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave", si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30. 09. 2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Monuni" shpk me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mikroçipa për qentë endacak" me numër te prokurimit 616-22-9226-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616-22-132-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 19 tetor 2022, mori këtë:

**VENDIM**

**Hedhet si e pa lejuar**, ankesa e OE "Monuni" shpk me seli në Gjilan, me nr. të protokollit 536/22, e datës 13 tetor 2022, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mikroçipa për qentë endacak" me numër te prokurimit 616-22-9226-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616-22-132-121, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës.

**I lejohe**t, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mikroçipa për qentë endacak" me numër te prokurimit 616-22-9226-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616-22-132-121, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimi të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej

gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale*

Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prishtinës me datën 07. 09. 2022 ka publikuar B05 - Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me mikroçipa për qentë endacak” me numër të prokurimit 616-22-9226-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616-22-132-121, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës. Bazuar në këtë njoftim afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 27.09.2022, hapja e ofertave është bërë me datën 27. 09. 2022 në ora 14:00. Në sistemin e prokurimit figuron që OE ankues “Monuni” shpk kërkesën për rishqyrtim e ka dorëzuar me datën 23. 09. 2022, 4/katër ditë para hapjes së ofertave.

Në sistemin e prokurimit nuk figuron vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim. OSHP ka dërguar email në AK duke i kërkuar sqarime, se lidhur me kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues me datë:23.09.2022, AK a ka marr vendim në pajtim me nenin 108/A të LPP-së.

AK KK Prishtina ka deklaruar se nuk kanë marr vendim në kërkesën e OE ankues sepse nuk e kanë vërejtur kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Me datën 14. 10. 2022 AK- KK Prishtinë ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë 13 tetor 2022, ka pranuar ankesë nga OE “Monuni” shpk me seli në Gjilan, për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me mikroçipa për qentë endacak” me numër të prokurimit 616-22-9226-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616-22-132-121, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vlerësohet se OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse afati i fundit për dorëzimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë ka qenë e data 27. 09. 2022, kurse OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 23.09.2022, pra OE ankues ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim 4/katër ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, e jo brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Ku paragrafi 3.1 i nenit 108/A i Ligjit për Prokurim Publik specifikon: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Dhe neni 4.1 pika (a) e Rregullave të Paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon:

*a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.*

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: “Monuni” shpk me seli në Gjilan, e datës 13.10.2022 me numër të Protokollit 536/2022, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4.1 pika (a) e “Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE-“Monuni” me seli në Gjilan
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së



Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani